



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare -QKMF "Adem Ukëhaxhaj" Deçan
Nr. 06/Zyrtarisht
Datë: 27.07.2023

Bazuar në nenin 67, 68 dhe 69 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, neni 8, të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, neni 5 i Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ (Shëndetësi) Nr. 02/2015, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, shpall:

KONKURS

Institucioni: Komuna e Deçanit

Njësia: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare -QKMF "Adem Ukëhaxhaj" Deçan

Lloji i pozitave: Nëpunës i Shërbimit Publik

Titulli i vendit të punës: Infermier/e

Kohëzgjatja e emërimi: E pacaktuar

Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën: Infermier/e

- Pranon, triazhon dhe informon pacientin, hap kartelën shëndetësore, merr anamnezën orientuese;
- Aplikon terapinë parenterale, i.m; i.v; s.c., aplikon inhalimin,
- Përpunimin e plagës;
- Përcjell kalendarin e imunizimit,
- Aplikon dhënien e oksigjenit.
- Bën dhënien e drejtë të terapisë sipas përshkrimit të mjekut;
- Mban dokumentacionin e infermierisë elektronike dhe të fortë;
- Përkujdeset për materialin që përdoret, administrativ dhe inventarin, (veçanërisht barnave – ampulare dhe sanitare);
- Ka për detyrë të bashkëpunojë ngushtë me shërbimet përkatëse dhe eprorët e vet;
- Kryen të gjitha punët e patronazhit në teren dhe edukimit
- Mban rendin dhe disiplinën;
- Zbaton urdhrat e mjekut.

2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- d. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- e. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale:

- a. Arsimimi i kërkuar:
- b. Shkolla e mesme e mjekësisë
- c. Fakulteti Bachelor i infermierisë;
- d. Licenca e punës;
- e. Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme:

- a. Të jetë i regjistruar dhe licencuar në MSH;
- b. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit);
- c. Të ketë gatishmëri të punojë me të gjitha grupet, pa dallim moshe, gjinie, kulture, etnie, religjioni apo race.

5. Numri i pozitave të kërkuara:

Nr.	Titulli i pozitës	Koeficienti	Nr. i kërkuar	Vendi i punës
1.	Infermier/e (Bachelor)	H17-5.4	3	QKMF
2.	Infermier/e (Shkolla e mesme e mjekësisë)	H20-5.1	1	QKMF

6. Mënyra e aplikimit:

Konkursi është i hapur në afat prej 15 ditësh nga data: **28.07.2023** deri me datë: **11.08.2023** aplikacionet merren dhe dorëzohen në objektin e Komunës së Deçanit-Zyra Pritëse, kati përdhes.

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- b. Kopjet e dokumentit personal (letërnjoftimi);
- c. Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore (personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit);
- d. Kopjen e licencës;

e. Dokumenti që nuk është nën hetim.

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- a. Testimi me shkrim dhe
- b. Intervistë.

9. Sqarime shtesë:

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit;
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi);
- c. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publikë;
- d. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.



Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale


Agnesa VOKSHI